



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Politikë dhe Financa**  
**Nr.01-060/01-7138/21 datë: 23.03.2021**



**Npi – 01/96 datë: 26.03.2021**

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 26.03.2021 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**  
**E mbajtur më datën: 26.03.2021 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit**

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari dhe znj.Adalina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët: Nga DKA, znj.Agime Roshaj, nga DSHMS, zMusa Baftiu, znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare, Lulzim Muharremi, zyrtar Ligjor dhe Lulzim Sahiti, zyrtar për informim.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**REND DITE**


1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 01.03.2021,
2. Propozim-Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit, Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
3. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba, sipas rekomandimit të MPL-së,
4. Propozim-Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2020 në vitin 2021,
5. Propozim për ndryshimin e Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë,
6. Propozim-Vendim për vazhdimin e Komisionit në përzgjedhjen e drejtorëve e zv.drejtorëve,
7. Draft-Statuti i ri i QKMF-së “Vezir Bajrami” në Shtime.

**Procesverbali Npi-01/96 i datës 26.03.2021**

**Me kërkesën e Kryesueses së Kuvendit znj.Medina Brahaj, diskutimi për mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më datën 26.03.2021, anëtarëve të KPF-së u është dërguar në formë elektronike në CD-Disc, dhe në formë të tillë e kanë miratuar.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 21.09.2021, me shumicën e votave miratoi procesverbalet në formë elektronike (CD-Disc) të datave: 01.03.2021, 26.03.2021, 01.06.2021, 22.06.2021, 09.07.2021 dhe 24.08.2021.**

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF  
Medina Brahaj